

URDHËR
Nr. 2, datë 4.11.2024

PËR BOTIM NË FLETOREN ZYRTARE TË KËRKESËS PËR NDRYSHIM EMRI

Bazuar në ligjin nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 90, datë 2.4.2014, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit”, urdhrin nr. 146, datë 19.5.2014, “Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit”,

URDHËROJ:

1. Botimin në Fletoren Zyrtare të kërkesës për ndryshimin e emrit të z. Hitler Kurti për një periudhë prej 15 ditësh.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

NËNPREFEKT I QARKUT DIBËR
Hasan Pasha

PUBLIKIM KËRKESE PËR NDRYSHIM EMRI

Në shqyrtim të praktikës për ndryshimin e emrit, për shtetasin Hitler Kurti, të paraqitur në Zyrën e Gjendjes Civile, të Njesisë Administrative Burrel, ku shtetasi në fjalë ka vendbanimin e tij, banues në Burrel, rruga “Kuvendi i Dukagjinit”, ndërtesa nr. 10, pasi janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, në zbatim të pikës 3, të nenit 57/4, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, sot më datë 4.11.2024, nënprefekti i qarkut Dibër autorizon publikimin në QBZ të kërkesës për ndryshimin e emrit të shtetasit për shkak të papërshtatshmërisë nga HITLER në ERI.

Në zbatim të nenit 57/5, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

NËNPREFEKT I QARKUT DIBËR
Hasan Pasha